

Në bazë të nenit 160 paragrafi (3) të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.178/21), dhe nenit 22 paragrafi (1) alinea 1, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit për marrëdhëniet e punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129 / 15, 27/2016, 120/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.110/19, 267/20, 151/21, 288/21 dhe 111/23), Universiteti "Nënë Tereza" në Shkupi shpall

KONKURS PUBLIK

për punësim të 4 (katër) personave në kohë të pa caktuar edhe atë:

1. ROJTAR(2) përmbaues
2. PORTIR (2) përmbaues

Kandidatët për vendet e lartëcekura të punës duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të kenë të mbaruar arsim fillor ose arsim të mesëm;
- Të jenë me ose pa përvojë pune.

Shuma neto e pagës bazë arrin deri 20.175,00 denarë.

Kandidatët përveç kushteve të posaçme të lartëpërmendura, duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme në vijim:

- ✓ Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- ✓ Në mënyrë aktive ta njohin (përdorin) gjuhën maqedonase;
- ✓ Të jenë të moshës madhore;
- ✓ Të kenë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- ✓ Të kenë dëshmi se nuk kanë të shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët i plotësojnë kushtet për të aplikuar.

Kandidatët së bashku me fletë aplikimin duhet të dorëzojnë edhe dëshmitë se i plotësojnë kushtet, në formë origjinale ose të vërtetuara nga noteri, edhe atë:

1. Dëshmi mbi shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
2. Dëshmi e shëndetit të përgjithshëm për vendin e punës – Certifikatë nga Instituti i Mjekësisë së Punës
3. Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
4. Certifikata / Diploma për nivelin e kryer arsimor në përputhje me kërkesat në konkurs;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës;

VËREJTJE: Për pozitën numër 1 përparësi do të kenë kandidatët që posedojnë licencë për sigurim.

Afati për dorëzimin e fletë aplikimeve me dokumentet e kërkuara do të zgjasë 3 **ditë pune** nga dita pas shpalljes së konkursit (duke përjashtuar ditën e shpalljes).

Kushtet e përcaktuara në konkurs, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Nëse në konkurs paraqiten 200 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 45 ditëve, nga 201 deri në 500 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 90 ditëve dhe më shumë se 500 kandidatë, zgjedhja duhet të bëhet brenda 120 ditëve, pas afatit për aplikim.

Fletë aplikimet me dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur në kampusin e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, në ish Kazermën Ilinden, kati i 3-të zyra e sekretarit teknik të Rektorit, me shënimin "konkurs për punësim në Universitet, për vendin e punës numër _____."

Fletë aplikimet jo të plota dhe ata që nuk i dorëzojnë në kohën e duhur nuk do të merren parasysh.

Afati i fundit për aplikim: 10.07.2023.

Kontakt telefoni: 02/3161-004

Me respekt,

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup